



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Ministrit - Kancelarija Ministra - Office of the Minister

Nr. 66 2016

Datë 04 . 07 . 2016

Në pajtim me nenin 323 paragrafi 1, nenit 328 paragrafi 1 dhe nenit 330 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën përmbare, si dhe në pajtim me nenin 8, nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR EMRIMIN E PËRMBARUESIT PRIVAT**

1. **Z. Gëzim (Sadri) Ademi**, Emërohet përmbare privat për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
2. Selia e të emëruarit do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
3. I emëruari, para caktimit të ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbare në pajtim me paragrafin 4 të nenit 331 të Ligjit për Procedurën përmbare, është i obliguar që në afat prej 60 ditësh nga dita e dhënies së betimit të ofroj dëshmitë se i plotëson kushtet sipas nenit 332 të Ligjit për procedurën përmbare.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Prof. Dr. Hajredin KUÇI**

Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë

**Udhëzimi juridik:** Kundër këtij vendimi mundë të ngritët konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

*Vendimi i dërgohet:*

- Përmbaresit privat të emëruar,
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë,
- Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

